



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.92/ 2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga Muhamet Rexha, kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi anëtarë, përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, paraqitur kundër Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në lidhje me parregullsi gjatë procesit zgjedhor, në seancën e mbajtur më 26.01.2011, mori:

VENDIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje.

ARSYETIMI

Më datë 23.01.2011 PZAP-i ka pranuar ankesë nga subjekti politik LVV në të cilën theksohet se me 23.01.2011 në Tavnik, komuna e Mitrovicës në shkollën fillore Migjeni në QV 1102b/06R kanë qenë 626 votues të regjistruar, në anën tjetër kanë qenë vetëm 600 fletëvotime.. Pala ankueso konsideron që është bërë shkelje e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, Neni 64, paragrafi 2, pika a, c, dhe e.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (c) parashohin si vijon:

3.6 (c) Hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi të gjitha shkresat e lendes gjeti se:

-ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstaton se pretendimet qe paraqet ankuesi nuk kane te bëjnë me dispozitën juridike qe është pretenduar se është shkelur ,përndryshe ankesa mbështetet ne supozime e jo ne fakte ngase me asnjë provë ankuesi nuk ka bërë të besueshme faktin se ne këtë vendvotim ka pasur shkelje e aqë me pare me dispozitën e pretenduar në ankesë Për këto arsye dhe bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5. 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitja

A nr. 92/2010 më datën 26.01.2011.

Kryesuesi i Panelit

Muharrem Rexha

